



URDHRI PROFESIONAL I MJEKUT VETERINAR TË SHQIPËRISË

KËSHILLI KOMBËTAR

Ent Publik Jobuxhetor, i krijuar me Ligjin nr. 113/2015 • Anëtar me të drejta të plota i FVE dhe UEVP

QËNDRIM ZYRTAR

mbi ligjshmërinë e sistemit të Zhvillimit Profesional të Vazhdueshëm (CPD), certifikimin e trajnimeve dhe administrimin e krediteve nga Urdhri Profesional i Mjekut Veterinar

Tiranë, më ____ . ____ .2026

I. Objekti i këtij qëndrimi

Urdhri Profesional i Mjekut Veterinar të Shqipërisë (UPMVSH), në cilësinë e entit publik jobuxhetor, profesional dhe të pavarur, të krijuar me Ligjin nr. 113/2015 “Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar”, konstaton me shqetësim përhapjen publike të pretendimeve të pavërteta, sipas të cilave Urdhri nuk do të kishte të drejtë të certifikojë trajnimet e Zhvillimit Profesional të Vazhdueshëm (CPD), se kreditet e lëshuara prej tij nuk do të njiheshin ose nuk do të ishin të ligjshme, dhe se anëtarët e Urdhrit do të rrezikonin humbjen e licencave për këtë shkak.

Këto pretendime janë të pabazuara në ligj, të pambështetura në asnjë akt zyrtar dhe në kundërshtim të hapur me kuadrin ligjor kombëtar, me standardet ndërkombëtare të profesionit veterinar dhe me praktikën e konsoliduar europiane. Ato kanë krijuar pasiguri të panevojshme te anëtarësia dhe cenojnë besimin publik ndaj një enti të krijuar me ligj të posaçëm të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Për këtë arsye, Këshilli Kombëtar i UPMVSH-së paraqet publikisht qëndrimin e mëposhtëm, të mbështetur tërësisht në fakte, ligje dhe referenca të verifikueshme.

II. Baza ligjore e pakontestueshme e sistemit CPD

1. Qëllimi dhe misioni i shpallur nga vetë ligjvënësi. Neni 1 i Ligjit nr. 113/2015 e përcakton qëllimin e ligjit: “vendosjen e standardeve për ushtrimin e profesionit të mjekut veterinar” — pra standarde për ushtrimin si veprimtari e vazhdueshme, jo vetëm për hyrjen në profesion. Neni 3 e plotëson me misionin e Urdhrit: “ruajtja e standardeve të larta në formimin, sjelljen profesionale dhe ushtrimin e profesionit”, ku formimi qëndron krah ushtrimit si objekt i përhershëm i veprimtarisë së Urdhrit. Një standard ushtrimi që nuk verifikohet kurrë pas diplomimit nuk është standard ushtrimi, por vetëm standard hyrjeje; Zhvillimi Profesional i Vazhdueshëm është, rrjedhimisht, instrumenti pa të cilin qëllimi i shpallur nga Kuvendi në nenin e parë të ligjit do të mbetet i pazbatueshëm.

2. Kompetencat e Ligjit nr. 113/2015. Ligji themelues i Urdhrit e ndërton në mënyrë të plotë arkitekturën ligjore të edukimit të vazhdueshëm profesional:

- **Neni 4, shkronja “a”:** Urdhri jep, pezullon ose heq të drejtën e ushtrimit të profesionit “në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe të statutit të Urdhrit” — delegim i shprehur ligjor që Statuti të përcaktojë kushtet e fitimit dhe të mbajtjes së licencës, përfshirë kërkesat e edukimit të vazhdueshëm;
- **Neni 4, shkronja “dh”:** Urdhri bashkëpunon me institucionet arsimore e shkencore për hartimin dhe planifikimin e programeve të formimit shkencor, specializimit pasuniversitar dhe kurseve të kualifikimit të vazhdueshëm;
- **Neni 4, shkronjat “e” dhe “gj”:** Urdhri planifikon, monitoron dhe organizon trajnime profesionale e testime aftësie, si dhe përgatit programe trajnimi në fushën e veterinarisë;
- **Neni 16, pika 1, shkronja “b”:** vetë ligji urdhëron krijimin pranë Këshillit Kombëtar të një komisioni të përhershëm “për standardet, arsimimin dhe kualifikimin”, veprimtaria e të cilit bazohet në rregullore të miratuar nga Këshilli Kombëtar (neni 16, pika 2).

3. Statuti i Urdhrit (i miratuar dhe i ndryshuar me vendim të Këshillit Kombëtar, në zbatim të nenit 15 pika “dh” të ligjit 113/2015) e zbërthen këtë kompetencë: neni 3 e lidh dhënien dhe mbajtjen e Certifikatës për Ushtrim Profesionit me pjesëmarrjen në kurset e edukimit profesional në vijimësi dhe me fitimin e krediteve; neni 14 e përcakton pjesëmarrjen në edukimin në vijimësi si detyrë të çdo anëtar; neni 21 sanksionon Komisionin e zhvillimit të standardeve, arsimimit dhe kualifikimit; neni 27 ngarkon Aparatin e Urdhrit me administrimin e Regjistrit të Krediteve.

4. Rregullorja e Komisionit përkatës, e miratuar nga Këshilli Kombëtar, përcakton në mënyrë të detajuar sistemin e plotë të edukimit të vazhduar: konvertimin e orëve të trajnimit në kredite me koeficientë sipas llojit të veprimtarisë (neni 6), detyrimin prej minimalisht 20 kreditesh në vit për çdo mjek veterinar të licencuar — 80% nga programi i edukimit të vazhduar dhe 20% nga vetëedukimi (neni 10) — kriteret-parakushte të çdo trajnimi, përfshirë kërkesën që përmbajtja të jetë e pavarur nga interesat tregtare të palëve të treta (neni 7), njohjen e trajnimeve të organizatave e shoqatave që lidhin marrëveshje bashkëpunimi me Urdhrit, me formular e tarifa të miratuara nga Këshilli Kombëtar (neni 12), si dhe njohjen e ndërsjellë të krediteve me trupat homologë të rajonit dhe konvertimin 1:1 të trajnimeve të huaja (neni 11). Rregullorja është hartuar sipas modelit të Unionit European i Veterinerve të Praktikuesve (UEVP), organizëm i lidhur me FVE-në, ku UPMVSH është anëtar me të drejta të plota në këto dy organizma.

5. Ligji nr. 10171/2009 “Për profesionet e rregulluara” e mbyll kuadrin ligjor me tre dispozita vendimtare. Neni 16, shkronja “c”, e përcakton si detyrim ligjor të çdo profesionisti të rregulluar — përfshirë veterinerin (neni 5, pika 1, shkronja “e”) — “të kujdeset për përditësimin e aftësive të veta profesionale”: pra edukimi i vazhdueshëm nuk është zgjedhje vullnetare, por detyrim i vendosur në ligjë nga vetë Kuvendi. Neni 18 parashikon se shkelja e këtij detyrimi ndëshkohet me masë administrative dhe se llojet e masave, autoriteti përgjegjës dhe procedurat “përcaktohen në ligjin për krijimin e UP-së përkatëse” — pra vetë ligji ia delegon Urdhrit, përmes Ligjit 113/2015, zbatimin e pasojave të mospërmbyshjes. Ndërsa neni 15, pika 3, sanksionon se organizimi dhe funksionimi i urdhrit profesional bëhet me ligj të veçantë — konfirmim se sistemi i krediteve i ndërtuar mbi Ligjin 113/2015, Statutin dhe rregulloren është pikërisht zbatimi i mandatit që Ligji 10171/2009 ia jep ligjit të posaçëm. Kush kundërshton sistemin e krediteve të Urdhrit, kërkon në thelb që detyrimi ligjor i përditësimit profesional (neni 16/c) të mbetet pa asnjë mekanizëm matjeje dhe zbatimi.

Zinxhiri normativ Ligji 10171/2009 – Ligji 113/2015 (nenet 1, 3, 4, 16) – Statuti – Rregullorja e Komisionit është i plotë, i miratuar nga organet kompetente dhe plotësisht i vlefshëm juridikisht. Çdo pretendim se ky sistem “nuk ka bazë ligjore” bie ndesh me tekstin e vetë ligjit.

III. Modeli europian dhe standardet ndërkombëtare: Urdhri vepron pikërisht si homologët e tij

Studimi zyrtar i FVE-së mbi cilësinë e CPD-së në Europë konstaton shprehimisht se “trupi akreditues për sigurimin e cilësisë është, në shumicën e vendeve, Trupi Statutor” i profesionit veterinar — pra pikërisht institucioni homolog i UPMVSH-së. Praktika konkrete e vendeve europiane e vërteton këtë:

- **Belgjikë:** CPD është i detyrueshëm që nga viti 2013; Urdhrat e Veterinerëve (NGROD dhe CRFOMV), nën Këshillin e Lartë, vendosin rregullat, njohin pikët e CPD-së dhe kërkojnë minimalisht 60 pikë në tre vjet për mbajtjen e regjistrimit;
- **Gjermani:** Dhomat Veterinare (trupi statutor) dhe Akademia e tyre e Edukimit të Vazhdueshëm (ATF) certifikojnë vetë trajnimet CPD me “ATF-orë”, me detyrim ligjor prej 20 orësh në vit për çdo veteriner;
- **Rumani:** CPD është i detyrueshëm me 120 pikë në vit; Kolegji i Veterinerëve të Rumanisë (CRV) i jep pikët, i verifikon dhe, në rast mospërmbyshjeje, Bordi Ekzekutiv tërheq përkohësisht ose përfundimisht të drejtën e ushtrimit të profesionit;
- **Poloni:** Komisioni i CPD-së i Këshillit Kombëtar Veterinar është autoriteti ekzekutiv për regjistrimin, verifikimin dhe dhënien e pikëve për çdo formë trajnimi, përfshirë ofruesit e jashtëm që aplikojnë pranë tij;
- **Mbretëri e Bashkuar:** RCVS, trupi statutor, e ka CPD-në të detyrueshme me 105 orë në tre vjet për të gjithë anëtarët praktikues;
- **Austri:** Dhoma Veterinare Austriake, përmes Rregullores së saj të Edukimit (Bildungsordnung, 17.12.2021), akrediton në mënyrë ekskluzive ofruesit dhe aktivitetet CPD;
- **Slloveni:** Dhoma Veterinare, e rregulluar me ligj të posaçëm, mban përgjegjësinë për standardet dhe mekanizmat e CPD-së, ndërsa ofrimi i trajnimeve mbetet i hapur për universitete, shoqata dhe subjekte të tjera — model identik me atë që zbaton UPMVSH.

Në nivel ndërkombëtar, neni 3.2.5 i Kodit Tokësor të WOAH (Organizata Botërore për Shëndetin e Kafshëve) kërkon që çdo shtet të ketë një trup statutor veterinar të rregulluar ligjërisht, përgjegjës për standardet e arsimit, kompetencës, etikës dhe zhvillimit profesional të veterinerëve. Direktiva 2005/36/EC e BE-së (Recitalet 11, 13, 39 dhe 40) e lë shprehimisht rregullimin e profesioneve dhe nxitjen e zhvillimit profesional të vazhdueshëm në kompetencë të autoritetit kombëtar të përcaktuar me ligj — që në Republikën e Shqipërisë është UPMVSH-ja.

Raporti zyrtar i FVE-së “Veterinary Regulators in Europe” (nëntor 2023), i cili anketoi 29 vende europiane, i rendit ndër detyrat klasike të çdo trupi statutor veterinar (VSB): “vendosjen e standardeve minimale të Zhvillimit Profesional të Vazhdueshëm, duke ofruar trajnime ose duke njohur kreditet/CPD nga institucionet arsimore” dhe “organizimin e kurseve CPD”. I njëjti raport konstaton se trupi akreditues për sigurimin e cilësisë së CPD-së është, në shumicën e vendeve, vetë Trupi Statutor; se 17 vende kanë sistem të

detyrueshëm CPD; se 12 trupa statutorë i ofrojnë vetë trajnimet; dhe se vendet me sistem të detyrueshëm njohin njëkohësisht trajnimet e ofruesve të tjerë — pikërisht modeli i dyfishtë (ofrim + njohje) që zbaton UPMVSH. Raporti dokumenton edhe struktura të posaçme të brendshme: Dhoma Veterinare e Hungarisë, ku vetë regjistrimi në profesion varet nga plotësimi i krediteve dhe funksionon komision i dedikuar CPD-je, — struktura identike me Komisionin e arsimimit dhe kualifikimit të parashikuar në nenin 16/1/b të Ligjit 113/2015 dhe nenin 21 të Statutit të UPMVSH-së.

Fakt vendimtar: në të njëjtin raport, FVE e përfshin Shqipërinë me profil zyrtar dhe dokumenton shprehimisht se trupi statutor shqiptar “ka një sistem CPD (të detyrueshëm)”, krahas kodit të etikës, sistemit disiplinor dhe strukturave të tij organizative. Pra sistemi CPD i UPMVSH-së nuk është vetëm i ligjshëm në planin e brendshëm — ai është tashmë i regjistruar, i njohur dhe i pasqyruar zyrtarisht në dokumentacionin e Federatës së Veterinerëve të Europës, krah për krah me sistemet homologe europiane. Të pretendosh se ky sistem “nuk njihet” do të thotë të mohosh dokumentet zyrtare të vetë organizmit europian që e ka pasqyruar këtë njohje.

UPMVSH është anëtar me të drejta të plota i Federatës së Veterinerëve të Europës (FVE) dhe i Unionit European të Veterinerëve të Praktikës (UEVP), dhe sistemi i tij i krediteve është ndërtuar sipas metodologjisë së këtyre organizmave. Rrjedhimisht, veprimtaria e Urdhrit nuk është thjesht e ligjshme — ajo është shprehja konkrete e harmonizimit të Shqipërisë me *acquis communautaire* dhe me praktikën e çdo vendi anëtar të BE-së, në rrugën e saj drejt anëtarësimit.

IV. Përgjigje e drejtpërdrejtë ndaj pretendimeve të përhapura

Pretendimi 1: “Urdhri nuk ka të drejtë të certifikojë trajnime CPD.” — I PAVËRTETË. E drejta buron nga nenet 4 (shkronjat a, dh, e, gj, ë) dhe 16/1/b të Ligjit 113/2015, zbërthehet në nenet 3, 14, 21 dhe 27 të Statutit dhe detajohet në rregulloren e miratuar nga Këshilli Kombëtar. Ky është i njëjti funksion që ushtrojnë të gjithë trupat statutorë homologë në Europë.

Pretendimi 2: “Kreditet e lëshuara nga Urdhri nuk njihen dhe nuk janë të ligjshme.” — I PAVËRTETË. Kreditet e administruara nga Urdhri janë të vetmet kredite juridikisht relevante për mbajtjen e Certifikatës për Ushtrim Profesionit në Republikën e Shqipërisë, sepse vetëm Urdhri ka, me ligj, kompetencën e dhënies, pezullimit dhe heqjes së kësaj të drejte (neni 4/a i Ligjit 113/2015). Asnjë subjekt tjetër — shoqatë, OJF apo ofrues privat — nuk ka kompetencë ligjore të njohë a të mohojë kredite për efekt licencimi.

Pretendimi 3: “Veterinerët do të humbasin licencat.” — I PAVËRTETË. Asnjë licencë nuk cenohet nga pjesëmarrja në sistemin e krediteve të Urdhrit — përkundrazi, pikërisht ky sistem është mekanizmi ligjor i mbajtjes së saj. Çdo masë ndaj një anëtari merret vetëm përmes procedurave të parashikuara në ligj (nenet 18–19 të Ligjit 113/2015), me garanci të plota procedurale dhe me të drejtë ankimi administrativ e gjyqësor.

Pretendimi 4: “Ka konflikt interesi kur Urdhri certifikon, monitoron kreditet dhe administron licencat.” — I PAVËRTETË. Ky është vetë thelbi i “vetërregullimit profesional”, i sanksionuar nga WOA, i dokumentuar nga FVE dhe i zbatuar nga çdo urdhër e dhomë veterinare europiane. Brenda Urdhrit funksionet janë të ndara me ligj: Komisioni i arsimimit dhe kualifikimit vlerëson trajnimet dhe kreditet; Këshilli Kombëtar vendos për licencat; Komisioni Disiplinor, si organ i pavarur gjykimi profesional, shqyrton shkeljet; ndërsa vlerësimi i trajnimeve kryhet sipas metodologjisë së UEVP-së, jo sipas kritereve arbitrare. Për më tepër, sistemi është i hapur: Urdhri njeh me kredite edhe trajnimet e universiteteve, shoqatave dhe

ofruesve të tjerë vendas e ndërkombëtarë që plotësojnë standardet, çka e përjashton çdo monopol trajnimi: neni 12 i rregullores parashikon shprehimisht marrëveshjet e bashkëpunimit me organizata e shoqata të certifikuar për trajnime, ndërsa neni 7 kërkon që përmbajtja e çdo trajnimi të jetë e pavarur nga interesat tregtare të palëve të treta — pra sistemi është ndërtuar pikërisht për të parandaluar kapjen komerciale, jo për ta mundësuar atë.

V. Mbi dezinformimin publik

UPMVSH konstaton se pretendimet e mësipërme përhapen nga individë që nuk janë anëtarë të Urdhrit dhe që flasin në emër të një shoqate, e cila nuk ka asnjë kompetencë ligjore mbi licencimin, kreditet apo edukimin e vazhdueshëm të profesionit. Shqetësimet e ngritura prej tyre kanë marrë tashmë përgjigje institucionale të plotë, me shkresa zyrtare, gjatë një periudhe mbi njëvjeçare. Vazhdimi i përhapjes së të njëjtave pretendime të rrëzuara, tashmë në formë publike, nuk përbën më kërkesë llogarie institucionale, por dezinformim që dëmton anëtarësinë dhe interesin publik.

Urdhri fton çdo palë të interesuar — përfshirë shoqatat profesionale — të kontribuojë në zhvillimin e profesionit përmes rrugëve institucionale: pjesëmarrjes në konsultime, propozimeve me shkrim dhe aplikimit për njohjen e trajnimeve të tyre me kredite, sipas kriterëve të barabarta e transparente të rregullores në fuqi. Njëkohësisht, Urdhri rezervon të drejtën t'u drejtohet organeve kompetente për çdo deklaram publik të rremë që cenon veprimtarinë ligjore të një enti publik dhe krijon panik të pajustificuar te profesionistët.

VI. Garanci për anëtarësinë

Këshilli Kombëtar i UPMVSH-së i siguron të gjithë mjekët veterinarë, farmacistët veterinarë dhe profesionistët e regjistruar se:

- çdo aktivitet i Urdhrit është në harmoni të plotë me Ligjin 113/2015, Statutin, rregulloret e brendshme dhe vendimet e Këshillit Kombëtar;
- kreditet e fituara në trajnimet e organizuara ose të njohura nga Urdhri janë plotësisht të vlefshme dhe regjistrohen në Regjistrin e Krediteve;
- asnjë licencë nuk rrezikohet nga zbatimi i sistemit CPD; përkundrazi, ai është garancia ligjore e mbajtjes së saj dhe e standardit profesional që publiku pret nga profesioni ynë;
- Urdhri mbetet i hapur për çdo pyetje të anëtarëve përmes strukturave të tij zyrtare.

Ky qëndrim publikohet në faqen zyrtare të Urdhrit dhe u përcillet për dijeni ministrisë përgjegjëse për veterinarinë, komisionit përkatës parlamentar dhe organizmave homologë ndërkombëtarë ku Urdhri anëtarësohet.

KËSHILLI KOMBËTAR
URDHRI PROFESIONAL I MJEKUT VETERINAR TË SHQIPËRISË

Referencat

Ligji nr. 113/2015 “Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar”; Statuti i UPMVSH-së (i ndryshuar me Vendim nr. 55, dt. 18.06.2020); Rregullorja e Komisionit të zhvillimit të standardeve, arsimimit dhe kualifikimit, miratuar nga Këshilli Kombëtar; Ligji nr. 10171/2009 “Për profesionet e rregulluara”; Direktiva 2005/36/EC dhe 2013/55/EU; WOA – Terrestrial Animal Health Code, neni 3.2.5; FVE – “Quality of CPD in Small Animal Medicine” (2015) dhe FVE Survey mbi trupat statutorë (2023); Bildungsordnung der Österreichischen Tierärztekammer (2021); Ligji dhe Statuti i Dhomës Veterinare të Sllovenisë.